



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Raporti Konsultativ

Shqyrtimi i shtatë i tarifave të energjisë elektrike

SHTE7 (2013-2017)

Vlerësimi i përkohshëm – Raporti i Detajuar mbi Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës (KOSTT sh.a.)

DEKLARATË

Ky Raport Konsultativ është hartuar për ZRRE për qëllime të pranimit të komenteve eventuale nga hisedarët. Nuk përfaqëson vendimin e ZRRE-së.

8 janar 2013

Përmbajtja

1	Hyrje	3
2	Vlerësimi i përkohshëm i Shpenzimeve të propozuara kapitale të KOSTT-it	3
2.1	Propozimet e Shpenzimeve kapitale të KOSTT-it.....	3
2.2	Kostot njësi të KOSTT-it.....	4
2.3	Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së për propozimet e shpenzimeve kapitale të KOSTT-it.....	5
3	Vlerësimi i përkohshëm i shpenzimeve të propozuara operative të KOSTT-it	6
3.1	Propozimet e KOSTT-it për shpenzimet operative (Opex).....	6
3.1.1	Nivelet e stafit	7
3.1.2	Shpenzimet e pagave dhe shpenzimet e ndërlidhura	8
3.1.3	Riparimet dhe mirëmbajtja	9
3.1.4	Shpenzimet tjera operative.....	9
3.1.5	Kostot e sigurimit	9
3.1.6	Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare	10
3.1.7	Rregullimi sekondar.....	10
3.1.8	Llogaritë e arkëtueshme nga tregtia	10
3.1.9	Vlerësimi i përkohshëm i propozimeve për shpenzime operative (Opex) të KOSTT-it nga KEK-u	10
4	Parametrat e tjerë rregullativ	11
4.1	Humbjet e lejuara dhe faktori i ndarjes së tyre	11
4.2	Faktori i efikasitetit	11
4.3	WACC – Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit	11
5	MAR-i i përkohshëm 2013-2017	12

1 Hyrje

Në një letër të datës 8 qershor 2012, ZRRE-ja paralajmëroi fillimin e Shqyrtimin e Tarifave të Energjisë Elektrike 7 (SHTE7), i cili, për herë të parë, do të mundësojë përcaktimin e të hyrave maksimale të lejuara të të licencuarëve për periudhë shumë vjeçare. Këto të hyra maksimale të lejuara do të duhej, me ligj, të ishin të mjaftueshme për të mbuluar kostot e arsyeshme operative dhe kapitale të kryerjes së aktiviteteve të licencuara. Llogaritja e të hyrave maksimale të lejuara nuk merr parasysh rregullimet të cilat kërkohen sipas Rregullave të Përcaktimit të Çmimeve për dallimet ndërmjet të ardhurave reale dhe të lejueshme në vitet paraprake.

Në harmoni me Rregullat e publikuara, ZRRE duhet të përcaktojë dhe të konsultohet lidhur me propozimet e saja për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) që mund t'i mbulojnë të licencuarit gjatë periudhës rregullative, si dhe arsyetimet për këto. Rregullat lejojnë që ZRRE të ndryshojë, fshijë apo të zëvendësojë ndonjë pjesë të propozimeve të të licencuarëve kur veprimet e tilla janë të arsyetuara.

Për të përcaktuar nëse të hyrat janë adekuate, ZRRE duhet të vlerësojë me kujdes kostot e parapara të të licencuarëve dhe të bindet që propozimet e tyre janë të arsyeshme dhe të qëlluara. Prandaj, duhet të ceket që, me ligj, të licencuarit janë të obliguar t'i ofrojnë të gjitha të dhënat të cilat ZRRE-së i nevojitet për këtë analizë. KOSTT-it i është kërkuar që t'i prezantojë parashtrësën e vet ZRRE-së dhe opinionit public më 3 shtator. Që nga kjo datë, ZRRE ka punuar për së afërmi me kompaninë për të qartësuar parashtrësat fillestare. KOSTT-i që atëherë ka parashtruar të dhëna dhe arsytetime domethënëse shtesë.

Ky dokument është pjesë përbërëse e këtij Vlerësimi të përkohshëm dhe duhet të lexohet bashkërisht me “Vlerësimin e përkohshëm – Pasqyrë” të botuar krahas këtij dokumenti dhe shtojcave të tij. Ai është strukturuar si më poshtë:

Pjesa 2 – Vlerësimi i përkohshëm i Shpenzimeve të propozuara kapitale të KOSTT-it

Pjesa 3 – Vlerësimi i përkohshëm i Shpenzimeve të propozuara operative të KOSTT-it

Pjesa 4 – MAR-i i përkohshëm 2013-2017

Pjesa 5 – Parametrat e tjerë Rregullativ

Shtojca – Raporti i vlerësimit teknik nga Sinclair Knight Merz

2 Vlerësimi i përkohshëm i Shpenzimeve të propozuara kapitale të KOSTT-it

2.1 Propozimet e Shpenzimeve kapitale të KOSTT-it

Më 19 tetor 2012, ZRRE lëshoi një dokument konsultimi (“Konsultimi i tetorit”) me të cilën përvijëzoi kuptimin e saj të aplikacionit të KOSTT-it deri më sot dhe kërkoi sqarime dhe arsytetime shtesë. Në veçanti, ZRRE i kërkoi KOSTT-it që të barazojë mospërputhjen e dukshme midis Planit më të fundit të

aprovuar të Zhvillimit të Rrjetit (2011) dhe projektet kapitale të përshkruara në parashtresën e vet të gushtit.

Në përgjigje të Konsultimit të tetorit, KOSTT-i i ka dorëzuar ZRRE-së informata të konsiderueshme shtesë. KOSTT-i ka sqaruar se Plani aktual i Zhvillimit të Rrjetit ishte përgatitur para Vendimit të Qeverisë për të transferuar një numër të aseteve 110kV dhe materialit të ndërlidhur si dhe stafit operacional nga KEK-u te KOSTT-i. Kjo bartje hyri në fuqi më 1 prill 2012. KOSTT-i ka deklaruar se asetet e bartura kërkojnë punë domethënëse riparuese për t'i sjellur në gjendje të njëjtë si pjesa tjetër e rrjetit të transmisionit dhe të vihen në funksion sipas standardeve ekzistuese operative për sistem. Parashtresa e KOSTT-it për TSHV prandaj përfaqësojnë një ri-përpunim domethënës të planit të mëhershëm të biznesit për të ri-prioritizuar shpenzimet kapitale në periudhën e ardhshme pesë-vjeçare, ri-përpunim ky i cili do të pasqyrohet në Planin e tyre të ardhshëm zhvillimor. Projektet kapitale të planifikuara në këtë periudhë përshkruhen në Shtojcën A, krahas një vlerësimi teknik të arsytimit të KOSTT-it për projektet të cilat kryhen në emër të ZRRE-së nga ana e inxhinierëve konsultues Sinclair Knight Merz.

Tabela a

Projektet e propozuara kapitale të KOSTT-it për transmision	2013	2014	2015	2016	2017	Totali
	€ m	€ m	€ m	€ m	€ m	€ m
Projektet e shpenzimeve kapitale të aprovuara në PZH e aprovuar						
Interkonektori Kosovë-Shqipëri						
Shpenzimet kapitale të ndërlidhura me ngarkesën	12.2	-	-	-	-	12.2
Shpenzimet kapitale që nuk janë të ndërlidhura me ngarkesën	7.7	2.0	-	-	-	9.7
Projektet totale kapitale të aprovuara	24.9	11.0	8.5	8.0	-	52.4
Projektet e shpenzimeve kapitale që nuk janë përfshirë në NDP						
Inter-konektori Kosovë-Shqipëri						
Shpenzimet kapitale të ndërlidhura me ngarkesën	1.1	14.4	18.7	7.1	12.6	53.9
Shpenzimet kapitale që nuk janë të ndërlidhura me ngarkesën	0.4	0.2	0.2	0.2	0.2	1.1
Totali i Projekteve të shpenzimeve kapitale që nuk janë përfshirë në NDP-në e aprovuar	2.5	15.5	18.9	7.3	12.8	56.9
Totali i Shpenzimeve kapitale	27.5	26.4	27.3	15.2	12.8	109.3

2.2 Kostot njësi të KOSTT-it

SKM vë në pah se kostot e KOSTT-it për njësi janë në përgjithësi më të ulëta se ato që janë parë gjeturi dhe në rast të pajisjeve të ndërprerjeve, janë 20-25% më të ulëta se sa që mund të pritej. Mirëpo, KOSTT-i ka dëshmuar, për të bindur ZRRE-në, se vlerat e cekura nga kompania në fakt përfaqësojnë koston blerëse e cila mund të gjendet në treg. Prandaj në kostot për programin e propozuar të

shpenzimeve kapitale (capex), ZRRE ka përdorur koston e KOSTT-it për njësi dhe pranon se ekziston një rrezik i ulët që këto të jenë të nën-vlerësuara.

KOSTT-i ka ofruar zbërthimin e shpenzimit në faza për periudhën 2013-2017. Shpenzimet e projektit i shtohen bazës rregullative të aseteve kur projekti lëshohet në funksion. KOSTT-i ka deklaruar se disa nga projektet do të duhet të kishin elemente të cilat lëshohen në funksion në faza, por aktualisht, nuk mund të ofrojë detaje, prandaj të gjitha projektet supozohet se do të vihen në funksion në fund të periudhës shpenzuese.

2.3 Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së për propozimet e shpenzimeve kapitale të KOSTT-it

Aplikacioni i rishqyrtuar i KOSTT-it e ka ndërlidhur secilin nga projektet e lartpërmendura me beneficione specifike sistemore dhe ka ofruar material ku sqarohet procesi i tyre i planifikimit. Më 8 nëntor, KOSTT-i ka prezantuar detaje mbi parashikimet e shpenzimeve kapitale të tyre, në veçanti për periudhën 2013 deri 2017. Këtu janë vënë në pah katër klasa kryesore të shpenzimeve krahas arsytimit për projektet e planifikuara dhe prioritizimin e tyre për nga beneficionet për sistemin dhe konsumatorëve në kuptim të besueshmërisë, disponueshmërisë dhe rritjes së sigurisë. Projektet janë shqyrtuar nga ZRRE dhe konsulentët e saj inxhinierik.

SKM konsideron se procesi i planifikimit i KOSTT-it duhet të rezultojë në një program të arsyeshëm dhe efikas të shpenzimeve kapitale. Është e qartë se KOSTT-i parapëlqen alternativë operative ndaj zgjidhjeve me shpenzime kapitale, dhe në lëmitë ku KOSTT-i mendon se mund të përmirësojë rjetin përmes procedurave operative, ka ofruar edhe detaje në PZH dhe ka shtyrë shpenzimet e ndërlidhura kapitale për periudha të mëvonshme. Përkundër kësaj, praktikat e KOSTT-it për menaxhim të aseteve do të mund të përmirësoheshin, dhe ky aspekt shtjellohet në Pjesën 3 në vijim (shpenzimet operative – opex).

Informatat e ofruara kanë mundësuar vlerësimin e koston për njësi e cila është përdorur në hartimin e planit. Kostot e ofruara nga KOSTT-i për njësi janë dhënë në ri-parashtresën e 24 shtatorit. KOSTT-i nuk ka ofruar shkallë, sasi të porosive, etj. për të mbështetur koston njësi dhe prandaj është e vështirë të bëhet një gjykim përfundimtar lidhur me adekuacinë e koston për njësi. Mirëpo, ZRRE vlerëson se koston e KOSTT-it për njësi duken të arsyeshme dhe në përgjithësi më të ulëta sesa që do të mund të pritej në tregjet e krahasueshme.

KOSTT-i ka identifikuar një numër të projekteve kapitale, pjesa më e madhe e të cilave është për divizionin e operatorit të transmisionit, me një numër të vogël të projekteve për operatorin e sistemit, që kanë të bëjnë kryesisht me zgjerimin e SCADA-EMS për të kontrolluar asetet 110kV të bartura nga OSSH. Operatori i Tregut nuk ka kërkesa kapitale për Periudhën e ardhshme Rregullative.

Edhe pse programi i KOSTT-it për shpenzime kapitale është dukshëm më i lartë se në PZH-së e mëhershme, kjo shkaktohet në rend të parë nga koston shtesë të ndërlidhura me renovimet e aseteve 110kV të cilat para pak kohe i janë bartur KOSTT-it nga KEK-u, 40% e të cilëve janë rreth 30-40 vjet të vjetra dhe me probleme mjaft të pranishme me tokëzim.

Aplikacioni i rishqyrtuar i KOSTT-it kërkon rreth €117 milionë të shpenzimeve kapitale për një periudhë pesë-vjeçare. Në vlerësimin e tyre teknik, SKM ka deklaruar se KOSTT ka ndërtuar

programin e vet kapital mbi baza të shëndosha inxhinierike. Megjithatë kur kihet parasysh profili i vjetërsisë së aseteve, është e qartë se propozimi i kompanisë paraqet një program mjaft të përmbajtur për zëvendësim të aseteve.

ZRRE vë në pah se SKM ka disa rezervime se shpenzimet jashtë projekteve të dhëna në zërin “shpenzime tjera infrastrukturore” bazohen mbi një tërësi të kostove buxhetore dhe jo mbi vlerësime të bazuara në pro-faktura, dhe ata kanë rekomanduar që ky zë buxhetor të zvogëlohet për 10%. Kjo ka ndikim të paktë në shpenzimet e rekomanduara kapitale.

Duke marrë parasysh këtë vlerësim dhe duke marrë parasysh se kostot e KOSTT-it për njësi janë të arsyeshme me përjashtimin e cekur, ZRRE propozon miratimin e programit të propozuar të KOSTT-it në tërësi. Shumat të cilat do të financohen përmes MAR-it janë dhënë në tabelën vijuese.

Tabela b

Nevojat e KOSTT-it për shpenzimet e propozuara kapitale (me përjashtim të granteve)	2013	2014	2015	2016	2017	Totali
	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's
Shpenzimet kapitale për projekte të operatorit të transmisionit KOSTT	27,594	27,490	26,368	15,313	12,846	109,611
Shpenzimet kapitale jashtë projekteve për operatorin e transmisionit KOSTT	2,316	669	103	138	216	3,442
Operatori i sistemit KOSTT	3,744	3,024	431	-	-	7,199
Totali	33,654	31,183	26,902	15,451	13,062	120,252

Profili i shpenzimeve të propozuara kapitale përmes TSHV-së sugjerojnë se nivelet e shpenzimeve kapitale do të ulen në vitet e mëvonshme, edhe pse në praktikë, vonesat mund të rezultojnë një profil më të njëtrajtshëm të shpenzimeve nga ai i dhënë më lartë.

Për sa i përket realizimit, ajo pjesë e programit të shpenzimeve kapitale e cila do të realizohet nga KOSTT-i është e renditjes së njëjtë (rreth €100M) me ato që KOSTT-i ka arritur në gjashtë vitet e fundit. Programi i përgjithshëm përfshin shpenzime domethënëse (rreth €15.5M) për asetet 110kV të cilat do të përgatiten nga aspekti inxhinierik dhe do të financohen nga KEK-u. Shumë prej projekteve të mbetura të financuara nga grantet do të përgatiten (në aspektin inxhinierik) nga të tjerët. Prandaj, duket e mundshme që KOSTT-i të realizojë programin e vet të synuar të shpenzimeve kapitale.

3 Vlerësimi i përkohshëm i shpenzimeve të propozuara operative të KOSTT-it

3.1 Propozimet e KOSTT-it për shpenzimet operative (Opex)

Në aplikacionet e tyre, KOSTT-i ka parashtruar kostot e propozuara operative për administratën qendrore, të cilat ZRRE do t'i alokojë në të gjitha bizneset e licencuara në proporcionin: Operatori i transmisionit – 80%; Operatori i sistemit – 17%; Operatori i tregut – 3%. Efekti i këtyre rialokimeve është dhënë në Tabelën 12, 13, dhe 14 të Aneksit 1.

Disa nga kostot e propozuara nuk mund të kontrollohen, siç janë tatimet. Të tjerët janë të kontrollueshme. ZRRE ka shqyrtuar parashikimet e kostove të kontrollueshme të KOSTT-it me ndihmën e inxhinierëve konsultues. Në rast të shpenzimeve vijuese, ZRRE konstaton se nivelet e shpenzimeve të parapara nga KOSTT-i nuk janë në tërësi të arsyetuara.

3.1.1 Nivelet e stafit

ZRRE ka shqyrtuar nivelet e propozuara të stafit të KOSTT-it për administratën qendrore dhe për operatorin e transmisionit, të sistemit dhe të tregut. Inxhinierët konsultues të ZRRE-së gjithashtu kanë vlerësuar nivelet e stafit të KOSTT-it në krahasim me bizneset tjera ndërkombëtare të OSTT-së, ashtu siç është përshkruar në pjesën 5.2 të raportit në Aneksin A. Treguesit afarist të stafit tregojnë se KOSTT-i nuk ka staf thelbësisht më të lartë se sa që do të pritej. Mirëpo, është e qartë nga të dhënat e ofruara se të gjitha nën-stacionet menaxhohen 24 orë me një rotacion të ndërrimeve. Kjo situatë do të duhej të zvogëlohej me përfundimin dhe zgjerimin e sistemeve SCADA.

Aktualisht, kompania nuk është në gjendje që të ofrojë informata të qarta lidhur me gjendjen e aseteve të veta dhe as të ndërmerr ndonjë analizë e cila shqyrton nevojën për zëvendësime bazuar në moshën e aseteve, informata që normalisht priten nga një ndërmarrje publike e energjisë elektrike e menaxhuar mirë, e cila pason praktikën e mirë ndërkombëtare. Nga kjo, SKM ka sugjeruar se burimet njerëzore duhet ri-përqendruar në të ardhmen për të rritur vëmendjen në menaxhimin e aseteve dhe jo në menaxhimin e nënstacioneve me regjimin e ndërrimeve. Është e qartë se këto do të jenë tërësi të ndryshme të shkathtësive dhe personeli mund të ketë nevojë për ri-trajnim, ose personel të rekrutuar me aftësi të reja. SKM ka vënë në dukje se 20 punëtorë të divizionit të transmisionit do të dalin në pension gjatë periudhës 2013-2017. Ata kanë sugjeruar se mbajtja e lejimit për këtë personel do t'i lejojë KOSTT-it të rekrutojë personelin shtesë, por më të kualifikuar për të kryer këto detyra më të kualifikuara. Për këtë arsye ZRRE nuk e ka zvogëluar lejimin duke marrë parasysh personelin që pritet të pensionohet.

Për stafin e **administratës qendrore** (HQ), KOSTT-i parasheh një rritje prej 6 punëtorëve për të menaxhuar programin e kapitalit të rritur për të plotësuar 40 punëtorë të HQ aktualisht të angazhuar në këto aktivitete, që paraqet një rritje prej 15%. Programi kapital 2008-2012 ishte €83.473m dhe parashikimi për 5 vitet 2013-2017 është €109.61m, rritje kjo prej 31% në programin e kapitalit. ZRRE-ja pajtohet që kjo rritje e personelit është e arsyetuar.

Për **Operatorin e transmisionit**, KOSTT ka propozuar një rritje të mëtejshme të stafit prej 14 personash gjatë periudhës për 2017 për shkak të zgjerimit të rritjes. Edhe pse vendosja e SCADA-EMS në të gjitha nënstacionet e transmetimit do duhej të lejonte operacionet e largëta të nënstacioneve 110/35kV, KOSTT-i nuk planifikon të reduktojë regjimin e menaxhimit të 24 orëve. Kompania pranon që kjo është e mundur (në të vërtetë ky është një arsyetim i madh për këtë teknologji), por planifikon që gradualisht ta vendosë atë në përdorim në të ardhmen. Kompania thotë se reduktimi i personelit ka implikime sociale dhe financiare përkitazi me ndërprerjen e punës që e bëjnë të vështirë për ta bërë stafin të panevojshëm edhe kur përparimet teknologjike tashmë i kanë bërë ata të tillë. Në kuadër të këtij propozimi të kompanisë për të rekrutuar sot 14 punëtorë shtesë që mund të mos nevojiten për disa vite, është për t'u vënë në pikëpyetje. ZRRE-ja mund të përfshijë vetëm shpenzimet e detyrimeve që lidhen me ruajtjen e niveleve të stafit ku ka një detyrë eksplicite në kompani për të mbajtur stafin i cili përndryshe do të jetë tepriçë. Si rezultat, ZRRE-ja konsideron se është e përshtatshme të supozojmë se operacionet nivelet e stafit të operacioneve të

transmetimit të mbeten në nivelin e 2012 gjatë periudhës së parashikimit. I mbetet KOSTT-it të merr në konsideratë se si më së miri të shfrytëzojë stafin e tij ekzistues. ZRRE-ja vë në pah se KOSTT-i ka kërkuar një lejim shtesë për rojet e sigurisë dhe pret që ata të përdoren për të menaxhuar rreziqet e sigurisë në nënstacione me personel të reduktuar.

Për **Operatorin e sistemit** KOSTT-i propozon një shtesë prej 6 punëtorëve gjatë periudhës për të operuar rrjetin e zgjeruar të kontrolluar nga SCADA. ZRRE-ja konsideron se këto rritje janë të arsyeshme duke marrë parasysh se kursimet janë bërë në staf në operacionet e transmetimit.

Për **Operatorin e tregut**, KOSTT-i nuk ka propozuar ndonjë rritje në stafin nga nivelet e vitit 2012 për periudhën e ardhshme të kontrollit dhe ZRRE-ja pajtohet se kjo është e arsyeshme.

Lejimi i ZRRE-së për nivelet e stafit është përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela c

Nivelet e propozuara të stafit nga KOSTT-i krahasuar me nivelet e stafit të lejuara nga ZRRE	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Zyra Qendrore KOSTT	77	83	83	83	83	83
Të lejuara nga ZRRE	77	83	83	83	83	83
Operacionet e Transmisionit KOSTT	239	242	247	253	253	253
Operacionet e Transmisionit - ZRRE	239	239	239	239	239	239
Operacionet e Sistemit KOSTT	43	44	47	49	49	49
Operacionet e Sistemit - ZRRE	43	44	47	49	49	49
Operacionet e Tregut KOSTT	10	10	10	10	10	10
Operacionet e Tregut - ZRRE	10	10	10	10	10	10
Stafi total KOSTT	369	379	387	395	395	395
Stafi total i lejuar nga ZRRE	369	376	379	381	381	381

ZRRE konsideron se këto nivele të stafit do të mund të redukohen edhe më tej. Në përcaktimin e Faktorit të efikasitetit, KOSTT synon të stimulojë kompaninë për të arritur përmirësime në produktivitet.

3.1.2 Shpenzimet e pagave dhe shpenzimet e ndërlidhura

Formatet raportuese të ZRRE-së iu kanë kërkuar kompanive që t'i bëjnë të gjitha parashikimet në terma reale, gjegjësisht në çmimet e vitit 2012, pasi që inflacioni do të aplikohet në të ardhmen, dhe atë në të hyrat e lejuara me ndryshimet vjetore. Në përgatitjen e parashikimeve për nivelet e pagave, KOSTT-i ka deklaruar se fluksi i stafit operacional dhe të mirëmbajtjes me pagesë më të ulët nga 110kV kanë ulur pagat mesatare. Prandaj, në parashikimin e tyre kanë aplikuar një rritje prej 2.5% mbi inflacionin për të kthyer pagën mesatare në nivelet e vitit 2011. ZRRE nuk e pranon këtë arsyetim: fluksi i stafit operacional ka ndryshuar proporcionin e stafit të KOSTT-it me kualifikime më të larta, të zvogëluar nga 53% në vitin 2011 në 40% në 2013 e tutje. Ky ndryshim ka kthyer KOSTT-in nga një organizatë me staf kryesisht profesional në atë me staf kryesisht operacional.

Tabela d

Nivelet e pagave të propozuara të KOSTT-it *	2012	2013	2014	2015	2016	2017
	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's	€ 000's
*(përfshirë kontributet pensionale dhe pagat e punëtorëve me kontratë mbi vepër)						
Parashikimet e pagave nga KOSTT-i	3,800	4,021	4,213	4,403	4,506	4,615
Pagat e lejuara nga ZRRE	3,800	3,901	3,941	3,968	3,968	3,968
Diferenca (euro 000's)	0	-120	-272	-435	-538	-647
% Diferenca	-	-3%	-6%	-10%	-12%	-14%

KOSTT-i konfirmoi që rritja prej 2.5% në fakt mund të mos aplikohet por pohon se kompania kishte për synim të rishqyrtojë strukturën e tyre organizative në mënyrë që kompaninë ta përafrojë me modelet ndërkombëtare për bizneset e OSTT. ZRRE konsideron se kjo është çështje për menaxhmentin e KOSTT-it por supozon se ndryshimet e tilla mund të bëhen në interes të rritjes së efikasitetit dhe jo të uljes së tij. ZRRE prandaj propozon që kostot e lejuara të pagave për OSTT të mbeten në nivel të vitit 2012.

3.1.3 Riparimet dhe mirëmbajtja

KOSTT-i ka ofruar një plan të detajshëm të mirëmbajtjes dhe buxhetit dhe ai është shqyrtuar me kujdes nga ZRRE dhe konsulentët e tij. Lëmia kryesore e rritjes është remonti i aseteve 110kV të cilat janë bartur nga KEK-u. KEK-u gjithashtu ka bartur pjesët rezerve të sistemit krahas aseteve dhe KOSTT-i ka konfirmuar se kostoja e këtyre pjesëve rezerve nuk është përfshirë në parashitesën për mirëmbajtje. ZRRE pret që ndikimi i kombinuar i programit të mirëmbajtjes dhe programi i shpenzimeve të planifikuara kapitale të jenë të mjaftueshme për t'i lejuar KOSTT-it të menaxhojë asetet e vjetëruara dhe të arrij një masë të ripërtërirjes së jetës së aseteve përtej supozimeve ekzisutese të KOSTT-it mbi jetëgjatësinë e jetës.

3.1.4 Shpenzimet tjera operative

KOSTT-i ka propozuar një numër të shpenzimeve në titullin "shpenzimet tjera operative". ZRRE ka shqyrtuar këto kosto të propozuara, dhe konstaton se shumica janë të arsyeshme duke marrë parasysh një kompani të madhësisë së KOSTT-it dhe natyrën e veprimtarisë së saj. KOSTT-i ka propozuar rritjen e vlerës së këtij zëri buxhetor nga €1,621,000 në vitin 2012 në €2,795,000 në vitin 2017. Mirëpo, në disa raste, ZRRE nuk është e bindur se kostot e ardhshme janë të arsyeshme apo janë arsyetuar në mënyrë adekuate nga kompania, dhe këto përshkruhen në pjesët 3.1.5 dhe 3.1.6 në vijim.

3.1.5 Kostot e sigurimit

KOSTT-i deklaroi në parashitesën e vet se kjo është një kërkesë e re por deri më tash, nuk kanë qenë në gjendje të gjejnë një sigures në Kosovë i cili do të ofronte mbulesë. Mirëpo, KOSTT-i ka €400,000 në vit në OT dhe €100,000 në vit për OS, totali prej €2.5m për këtë periudhë. ZRRE propozon mënjanimin e këtyre kostove të vlerësuara deri sa KOSTT-i të mund

të dëshmojë se mund të gjejnë sigurim të duhur, për t'iu shmangur dhënies së një fitimi të fryrë kompanisë. ZRRE do të vazhdojë shqyrtimin vjetor të çështjes së sigurimi, dhe vë në pah se në rast të humbjes së pasigurueshme jashtë kontrollit të ZRRE-së, kompania mund të aplikojë për ndryshim të MAR-it.

3.1.6 Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare

KOSTT-i ka paraparë një rritje në koston e udhëtimeve zyrtare për periudhën e ardhshme të rishqyrtimit. Shtegu historik i shpenzimeve sipas këtij zëri buxhetor nuk është i qartë. ZRRE beson se, pa arsyetim shtesë për rritjen e shpenzimeve, do të ishte më e qëlluar që shpenzimet të mbesin në nivelet e vitit 2012.

3.1.7 Rregullimi sekondar

KOSTT-i ka përfshirë parashikime të Opex-it për Rregullimin total prej €8.4m. ZRRE përkohësisht e ka përfshirë këtë në lejimin e MAR-it por KOSTT-i duhet të ofrojë dëshmi të marrëveshjeve të nënshkuara me operatorë ekonomik për shërbime të tilla para se kostot të mund të konfirmohen në llogaritjen përfundimtare të MAR-it.

3.1.8 Llogaritë e arkëtueshme nga tregtia

KOSTT-i ka paraparë një kosto të pritur të afarizmit prej rreth €9,446,000 që dalin nga mos pagesa e pritur e faturave të KOSTT-it nga KEK-u. ZRRE nuk e pranon këtë kosto pasi që nuk do të duhej të shkactohej në një treg funksional. Në rast të paraqitjes së problemit të mos pagesës në të ardhmen nga ndonjë palë e tretë, ai duhet të parashtrohet tek ZRRE për veprime rregullative. Kjo kosto e propozuar prandaj refuzohet në tërësi.

3.1.9 Vlerësimi i përkohshëm i propozimeve për shpenzime operative (Opex) të KOSTT-it nga ZRRE

Vlerësimi i përkohshëm i ZRRE-së lidhur me shpenzimet operative të KOSTT-it përmbledhet në tabelën në vijim. Ai paraqet një ulje në krahasim me propozimin e KOSTT-it prej rreth €23 milionë për periudhë kontrolluese prej pesë viteve, ulje kjo prej rreth 37%.

Tabela e

Vlerësimi fillestar i ZRRE-së për OPEX-in e KOSTT	2013 €000	2014 €000	2015 €000	2016 €000	2017 €000	Gjithsej €000
OPEX-I I propozuar nga KOSTT	13,627	11,518	11,685	12,283	12,485	61,599
OPEX-I I propozuar nga ZRRE	7,563	7,674	7,774	7,839	7,919	38,768
Ndrshimi (€ 000)	-6,064	-3,844	-3,912	-4,445	-4,567	-22,831
Ndryshimi (%)	-44.50%	-33.38%	-33.47%	-36.19%	-36.58%	-37.06%

Faktorët me ndikim më të madh në vendimin e ZRRE-së kanë qenë heqja e provizionit për borxhe të këqija dhe për shërbime ndihmëse, sipas arsytimit të dhëna në Seksioneve 3.1.7 dhe 3.1.8 të këtij Dokumenti.

4 Parametrat e tjerë rregullativ

4.1 Humbjet e lejuara dhe faktori i ndarjes së tyre

ZRRE konsideron se investimet kapitale shtesë do të kontribuojnë në reduktim të mëtutjeshëm të humbjeve megjithatë pret që reduktimet marginale në humbje të reduktohen gradualisht. Për këtë arsye ZRRE konsideron që është e arsyeshme që niveli i lejuar i humbjeve të KOSTT-it të caktohet në 1.8% me faktor të ndarjes së humbjeve prej 50%.

4.2 Faktori i efikasitetit

Me Rregullin për përcaktimin e çmimit, ZRRE obligohet që të përcaktojë një faktor efikasiteti i cili do të vlejë për kostot operative dhe të mirëmbajtjes të KOSTT-it. Për tërë periudhën e TSHV-së, do të përcaktohet një faktor i vetëm dhe atë në nivel i cili pritet të pasqyrojë fitimet të cilat mund të priten gjatë kësaj periudhe nga një i licencuar efikas. Në përcaktimin e nivelit të efikasitetit, ZRRE ka marrë parasysh kostot dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga KOSTT-i, krahas niveleve të produktivitetit në kompanitë e krahasueshme ndërkombëtare. Gjithashtu, ka marrë parasysh nivelet e faktorit të efikasitetit të cilët janë aplikuar me sukses në regjimet rregullative gjetiu nëpër botë.

ZRRE konstaton se ka hapësirë për fitime domethënëse në efikasitet në veprimtarinë e KOSTT-it, posaçërisht pasi kjo do të jetë herë e parë që është aplikuar një faktor efikasiteti në kompani ndërsa përvoja tregon që kompanitë janë në gjendje të demonstrojnë përfitime në efikasitet në këtë fazë të hershme të rregullimit të bazuar në nxitje. ZRRE konsideron se vlera prej 4% në vit është një faktor i qëlluar në periudhën e TSHV-së, që përfaqëson një stimulim sfidues për KOSTT-in që të ul koston e vet dhe të përfitojë në rast të performancës më të mirë nga ajo e pritura, duke krijuar kështu përfitime edhe për konsumatorë përmes uljes së presionit në tarifa.

4.3 WACC – Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit

ZRRE ka caktuar Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit për KOSTT-in duke u bazuar në vlerësimet e mëhershme lidhur me Kthimin e nevojshëm në Ekuitet, koston aktuale të financimit nga borxhi dhe nivelin actual të leverazhit (me përjashtim të kufizimeve të vëna në Diskutimet e ZRRE-së për WACC-un në kuadër të SHTE6).

Fillimisht ZRRE ka supozuar se të gjitha kompanitë e rregulluara kërkojnë kthim komercial në ekuitet. Më tutje ZRRE ka kërkuar nga Qeveria udhëzime lidhur me nivelin e kthimit në ekuitet që qeveria do të kërkonte si pronare e vetme e kompanive publike. Qeveria është shprehur se do të konsiderojnë kthim më të ulët në ekuitet nga operatorët në pronësi publike krahasuar me kthimin që do të mund të kërkohej nga një operator privat. Vlerësimi fillestar i ZRRE-së është se niveli i kthimit në ekuitet prej 8.0% (pas taksës) do të ishte i duhur për kompani në pronësi publike. ZRRE ka përdorur këtë kthim në ekuitet për të vlerësuar WACC-un e divizionit të KOSTT-it.

WACC-u rezultues për KOSTT është 6.73% (real, para tatimit)

5 MAR-i i përkohshëm 2013-2017

Pas vlerësimit të propozimeve të KOSTT-it për kostot kapitale dhe operative, vlerësimi i përkohshëm i shpjeguar më lartë,, si dhe parametrat e propozuara rregullative, ZRRE ka llogaritur MAR-in për veprimtaritë e licencuara të KOSTT-it në përputhje me Rregullin për përcaktimin e çmimeve të OST. Këto janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tabela G

Vlerësimi i përkohshëm i MAR për bizneset e licencuara të KOSTT-it	2013 € m	2014 € m	2015 € m	2016 € m	2017 € m	Gjithsej € m
Gjithsej	18.6	19.2	20.1	20.8	21.8	100.6